

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEGA SUHAREKË, Gjyqtari Qemail Suka, me pjesëmarrjen e Sek. Juridike Vjollca Haziraj, në lenden penale sipas P.Th. nga Prizreni Aktakuzës **PP.nr. 855-4/16 te dt. 17.05.2016**, kunder te akuzuarve M. Sh. nga Prizreni, dhe I. M. nga Prizreni, per shak te vepres penale vjedhje nga neni 325 paraga. 1 lidhur me nenin 31 te KP-se, në prezencë të prokurorit te PTH-së nga Prizreni Milot Krasniqi te akuzuarit, në seancën e shqyrtimit gjyqësor te mbajtur me dt. 02.03.2018 mori publikisht shpalli dhe me date 02.03.2018, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Te akuzuarit:

1. M. Sh. nga i ati R., e ema S., e lindur K., i lindur me dt. 23.08.1980 ne Prizren, ku edhe tani jeton ne rrugen “ J. G.” nr. 73/6, me numer personal, ka te kryer shkollen e mesme, mekanik, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës se Kosovës.

2. I. M., nga i ati A. , e ema sh., e lindur B., i lindur me dt. 11.09.1968 ne Prizren, ku deh tani jeton ne rrugën “B. e Ll.” L/51, nr. 28, me numer personal, ka te kryer shkollen e mesme, i pa pune, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës se Kosoves.

JANË FAJTOR

Sepse me date 09.03.2016 rreth ores 14.54 minuta, ne fshatin S. Komuna e suharekes, pikerisht ne market “P.”, me qellim te pervetesimit te kunderligjshem per vete apo personin tjeter, marrin pasurine e luajtshme – pije alkoolike te demtuarit F. G., ne ate menyre qe te pandehurit ndalin automjetin e tyre, hyne ne market marrin 2 shishe “Vodka Smimol” dhe me pas largohen nga vendi i ngjarjes me qrast kapen nga audio inqizimet e kamerave te marketit.

Me këto veprime kane kryer veprën penale, vjedhje nga neni 325 paraga. 1 lidhur me nenin 31 te KP-se,

Andaj gjykata në kuptim të nenit 41,51,52, 73,74 KP si dhe 359 parag. 1 dhe 2,dhe neni 325 paraga. 1 lidhur me nenin 31 KPK, dhe neni 345 paraga. 1 lidhur me nenin 31 te KPK, të akuzuarve iu shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Te akuzuarit M. Sh.,

Duke ia caktuar **dënimin prej 3 (tre) muajve burgim, si dhe dënimin me gjobë në shume prej 100 (njqindë) euro**, të cilit dënime nuk do të ekzekutohen në afatin e verifikimit prej një viti , nëse i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale

Te akuzuarit I. M.,

Duke ia caktuar **dënimin prej 3 (tre) muajve burgim, si dhe dënimin me gjobë në shume prej 100 (dyqindë) euro**, i cili dënim nuk do te ekzekutohet ne afatin e verifikimit prej një viti, nëse i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale.

Obligohen te akuzuarit qe ne emer te paushallit gjyqesor ta paguajne shumen prej 20 euro, se cili veq e veq , si dhe ne emer te kompenzimit te viktimave shumen prej 30 euro, se cili veq e veq, pas plotefuqishmeris se ketij aktgjykimi.

Udhëzohet pala e dëmtuar, F. A. G. nga fsh. S. KK Suhareke, që kërkesën pasurore-juridike ta realizoje në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

PTH-e me aktakuzë **PP.nr. 855-4/16 te dt. 17.05.2016**, kunder te akuzuarve M. Sh. nga prizreni, dhe I. M. nga Prizreni, per shak te vepres penale vjedhje nga neni 325 paraga. 1 lidhur me nenin 31 te KP-se, të cilin gjatë seancës së shqyrtimit fillestare e ka përfaqësuar PSH nga Prizreni Milot Krasniqi, i cili në tërësi ngel pranë të dhënave si në aktakuze, që te akuzuarit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

Gjykata në shqyrtimin e sotëm dhe me vet pranimin nga ana e te akuzuarve ka vërtetuar këtë gjendje faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 257 te KPP-ës ne shkresat e lendes nuk ka gjetur ndonjë prove te pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se te akuzuarit, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë, pranimi i fajit nga ana e te akuzuarve, është bere vullnetarisht ne shqyrtimin fillestar, pranimi është mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban aktakuza, te cilat gjinden ne shkresat e lendes si dhe provat materiale te paraqitura ndaj te akuzuarve nga ana e PTH ne Prizren.

Gjykata po ashtu ne tërësi ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë ne shqyrtimin fillestare nga ana e te akuzuarve, është bërë ne pajtim me dispozitat e nenit 248 te KPP-se, nga se nuk ekziston ndonjë nga arsyet dhe kushtet për hedhjen e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale.

Nga këto fakte te cilat i përmbanë aktakuza, Gjykata ka ardhur ne përfundim se me veprimet e te akuzuarve formohen te gjitha elementet e vepres penale vjedhja nga neni 325 paraga. 1 lidhur me nenin 31 te KP-se, andaj Gjykata ka vendosur te akuzuarit ti shpall fajtor dhe t'iu shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjate marrjes se vendimit mbi dënimin ka vlerësuar te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KP-ës, te cilat ndikojnë ne lartësinë e dënimit.

Gjykata si rrethane lehtësuese mori për bazë se te akuzuarit kane pasur qëndrim korrekt ndaj Gjykatës, kane bere pranimin e fajësisë ne mënyrë vullnetare, janë penduar për veprën e kryer penale pati parasysh edhe qellimin e lendimit, qi ti parandaloj kryesit nga kryerja e veprave penale ne te ardhmen, te njejtit te rehabilitohen, eshte hera e pare qe bie ndesh me Ligjin, kurse rrethana posaçërisht renduese nuk gjeti.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike e mori ne kuptim te nenit 463 te KPPK-ës

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u mori ne kuptim te nenit 453 parag, 4 të KPPK-ës.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA SUHAREKE

Gj y q t a r i
Qemail Suka

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtine, përmes kësaj Gjykate.